



Në bazë të nenit 24 të Ligjit Nr. 03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", 06 Prill 2009), në bazë të nenit 17 shkronja (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pikat 3 dhe 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2023, merr këtë:

## V E N D I M

### Për miratimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2023-2028

#### Neni 1

Miratohet Plani Lokal për Veprim në Mjedis 2022-2026, më qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm komunal, sipas specifikave në Komunën e Deçanit.

#### Neni 2

Plani Lokal për Veprim në Mjedis përmbanë të gjitha elementet themelore, të cilat janë përcaktuar në nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit më Nr. 03/L-025, dhe elementeve strategjike të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis.

#### Neni 3

**Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal për veprim në Mjedis 2023-2028.**

#### Neni 4.


Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtoritë e Komunës së Deçanit.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**01.Nr.II-4**

**Deçan, dt.28.02.2023**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Hajdar SUTAJ**





Sipas LMFPP dhe Ligjin Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 të datës: 30.12.2022, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI PARAPRAK 2022 NË VITIN AKTUAL FISKAL 2023

#### I.

Me këtë Vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti paraparak 2022 në vitin aktual fiskal 2023, sipas LMFPP dhe Ligjin Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 të datës: 30.12.2022.

*Totali për bartje është **shuma prej 183.174,58€ fondi burimor(21)**, si në pasqyrën e paraqitur më poshtë:*

*-Programi shërbime Publike mbrojtje civile dhe emergjente, nenprogrami infrastruktur rrugore, Kategoria ekonomike Investimeve kapitale. Bartet shuma totale 183.174,58 euro, të cilat janë THV nga fondi burimor (21), të arkëtuara në muajin nëntor dhjetor dhe të alokohen në kodet e projektit:*

*Blloku kodues: 21/631/18015/300/52958/ 0451 Mirëmbajtja Verore dhe Dimërorë e Rrugëve në Komunën e Deçanit - shuma 129,394.58 euro – Obligime ndaj kompanisë së kontraktuar për punët e kryera.*

*Blloku kodues: 21/631/18015/300/53127/ 0451 Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan - shuma 33,780.00 euro Obligime ndaj kompanisë së kontraktuar për punët e kryera.*

*Blloku kodues: 21/631/18015/300/52958/ 0451 Rregullimi dhe asfaltimi i infrastrukturës të çerdhja në Deçan - shuma 20,000.00 euro.*

#### II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: - Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtoritë tjera relevante të Komunës së Deçanit.

#### III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

#### IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, MAPL, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoritë tjera relevante dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-3

Deçan, dt.28.02.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ

Stampa e Komunës së Deçanit me datë 08.03.23 dhe shprehjet "Shavencol: Shumë 7384" dhe "01".



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2023, bie këtë:

## V E N D I M

### PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT – PLANIT PËR INTEGRITET TË KOMUNËS SË DEÇANIT 2023-2027

#### I.

Miratohet Vendimi për vënien në Diskutim Publik të Draft-Planit për Integritet të Komunës së Deçanit 2023-2027.

#### II.

Vënia në Diskutim Publik e Draft- Draft-Planit për Integritet të Komunës së Deçanit 2023-2027, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët, në mënyrë që i njëjti të jetë sa më funksional për subjektet implementuese dhe të tjerët.

#### III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

#### IV.

Vendimi bëhet transparent përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-6

Deçan, dt.28.02.2023



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ







Në pajtim me nenin 12, paragrafi, 12.2 shkronja (c) dhe nenin 17 shkronja (f) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina neni 15 paragrafi 1.8 dhe neni 34 paragrafi 2, sipas dispozitave të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019-nenit 25 paragrafi 1. dhe Nenit 26 pika 17, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të dt.02.02.2023, nr.219-2/23, për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2023, miraton këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01.NR.I-5,**  
**DT.31.01.2019 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT**

**Neni 1.**

**Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores 01.Nr.I-5, dt.31.01.2019, për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit.**

**Neni 2.**

**Ndryshohet dhe plotësohet neni 9-Tarifa Për Grumbullim, Transportim, Dhe Deponim Të Mbeturinave, që përcakton Kategoritë e konsumatorëve të cilët paguajnë faturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave, të specifikuar në tabelën si më poshtë:**

| Kategoria                                     | Tarifa paraprake | Parashikimi i rritjes në % | Parashikimi i rritjes në vlerë € | Tarifat e reja |
|-----------------------------------------------|------------------|----------------------------|----------------------------------|----------------|
| Kategoria e Konsumatorëve shtëpiak - Amviseri | 4.65 €           | 47.31%                     | 2.20 . €                         | 6.85 €         |
| Kategoria e Konsumatorëve Jo rezident         | 1.00 €           | 100%                       | 1.00 €                           | 2.00 €         |
| Veprimtarit e vogla zejtare dhe shërbyese     | 5.40 €           | 20 %                       | 1.08 €                           | 6.48 €         |
| Subjektet e mesme deri të mëdha Komerciale    | 9.30 €           | 20 %                       | 1.86 €                           | 11.16 €        |

|                                                                                                                                      |         |      |        |         |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|------|--------|---------|
| Subjektet e mesme deri të mëdha Komerciale / Industriale me kosto të moderuar të shërbimit                                           | 13.03 € | 20 % | 2.61 € | 15.64 € |
| Subjektet e mesme deri të mëdha Komerciale / Industriale me kosto të larte të shërbimit                                              | 16.76 € | 20 % | 3.35 € | 20.11 € |
| Subjektet e mesme deri të mëdha Komerciale / Industriale të shërbyera me kontrata të veqanta, konkretisht me kontenjer 1.1 me zbraze | 12.10 € | 20 % | 2.42 € | 14.52 € |
| Subjektet e mesme deri të mëdha Komerciale / Industriale të shërbyera me me kontenjer 7 meter kub                                    | 36.80 € | 20 % | 7.36 € | 44.16 € |

**Vërejtje : çmimet janë me TVSH**

**Sqarim: Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë për çdo pagesë Tarifën prej 6.85 € në muaj, nga 6.00 € do të paguan konsumatori, ndërsa 0.85 euro cent do të paguhet nga buxheti i Komunës së Deçanit.**

**Kjo mënyrë e pagesës do të vlenë deri në një vendim tjetër të Kuvendit.**

Neni 3.

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Deçanit dhe Menaxhmenti i N.P.L “Higjiena”Sh.A. për zbatimin e kësaj Rregullore.

Neni 4.

Rregullorja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Neni 5.

Me këtë Rregullore paisen:MAPL, Drejtoria Komunale për Shërbime Publike Menaxhmenti i N.P.L “Higjiena”Sh.A. dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-8/1

Deçan,dt.28.02.2023

01.Nr.II-8/1  
Deçan,dt.28.02.2023

K.K. Deçan AS 7389  
01 08.03.23



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ





Në bazë të Kërkesës së Kryetarit të Komunës, të dt.17.01.2023, nr.01-1749, sipas dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1, nenit 17 shkronjat a), b) dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), Në bazë të nenit 6 paragrafi 1, të Ligjit nr.2003/11 për Rrugë i ndryshuar dhe Platësuar me Ligjin Nr.03/L-120 për Rrugë, Ligjit Nr. 06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 për Rrugë, neni 3 paragrafi 5.2, neni 11 paragrafi 16.1, neni 12 paragrafi 18.1, të Ligjit nr. 03/L-120 për Rrugë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.03/L-120 për Rrugë, Ligjit Nr. 06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për Rrugë. si dhe nenit 15 pikat 1, 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të dt.16.02.2023, nr.2016, për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2023, miraton këtë:

## V E N D I M

### PËR HAPJEN E RRUGËS SË RE NË QYTETIN E DEÇANIT

#### I.

Me këtë vendim aprovet propozimi i Kryetarit të Komunës për hapjen e rrugës së re në qytetin e Deçanit.

#### II.

Rruga e re do të hapet në pronën komunale Zona Kadastrale Deçan, me gjatësi 250.56m, me gjerësi 6.00m, plus trotuare nga 1.5m, që në total është 9.00 m e gjerë, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=2255m^2$ , e cila mundëson zhvillimin e zonës në interes të përgjithshëm publik.

Rruga e re do të hapet:

Në parcelën nr. 00551-0, sipërfaqja që merret për rrugë  $593m^2$ ;

Në parcelën nr.00580-1 sipërfaqja që merret për rrugë  $108m^2$ ;

Në parcelën nr.00428-0 sipërfaqja që merret për rrugë  $819m^2$ ;

Në parcelën nr.02001-0 sipërfaqja që merret për rrugë  $104m^2$  dhe,

Në parcelën nr.00421-0 sipërfaqja që merret për rrugë është  $735m^2$ .

#### III

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Deçanit.

#### IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

#### V.


Me Vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-8/2

Deçan, dt.28.02.2023



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ







Sipas dorëheqjes së parevokueshme të ofruar me shkrim nga z.Armend Loshaj, anëtar i Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" Sh.A., të dt.24.02.2023, nr.01-6035. Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", në bazë të nenit 5 paragrafit 5.2 të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të neneve 15 dhe 27 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01-Nr-IX-5, i datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.02.2023, miratoj këtë:

## V E N D I M

### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "HIGJIENA" SH.A.

1.Me këtë Vendim Ndryshohet dhe plotësohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" Sh.A, i datës 31.01.2022, 01.Nr.I-9.

Me anë të tij vendimi Aprovohet dorëheqja e parevokueshme nga pozita e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "HIGJIENA" Sh.A. e z.Armend Loshaj, i lindur me dt.30 Qershor 1996, me nr.personal 1243875931. përfaqësues i Asamblesë, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK.

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "HIGJIENA" Sh.A. emërohet, z.Shkodran Mustafaj, i lindur me dt.29 Tetor 1986 ,me numër personal 1173539661. përfaqësues i Asamblesë, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK.

2.Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjin, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012) dhe më Ligjin Nr-06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018" dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

3. Mandati i z.Shkodran Mustafaj zgjatë, aq sa zgjatë mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve i themeluar me vendim të Kuvendit, me dt.31.01.2022.

4.Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.II-8/3

Deçan,dt.28.02.2023



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ

|                                                         |                                |
|---------------------------------------------------------|--------------------------------|
| REPUBLIC OF KOSOVA<br>KOMUNA E DEÇANIT<br>OPSTINA DEÇAN |                                |
| Në bazë të: <u>K.K. Deçan As 7382</u>                   |                                |
| Nr. i detyrës: <u>01</u>                                | Nr. i detyrës: <u>08.03.23</u> |